



Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 nën c. nenit 52 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040, nenit 10 nën pikën 3, dhe 18 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e IV-të të rregullt, të mbajtur më 29.05.2015, mori këtë:

V E N D I M

Për

Lëshuarje në diskutim publik të Raportit të Komisionit Komunal për sistemimin e adresave në territorin e Komunës së Klinës-për emërimin e rrugëve dhe shesheve në qytet dhe fshat

I

Miratohet vendimi për Lëshuarje në diskutim publik të Raportit të komisionit komunal për sistemimin e adresave në territorin e Komunës së Klinës-për emërimin e rrugëve dhe shesheve në qytet dhe fshat.

II

Raporti si në pikën 1 të këtij vendimi lëshohet në diskutim publik 15 ditë prej ditës së shpalljes në tabelën e shpalljeve dhe web faqen e Komunës.

III

Brenda 15 ditëve të diskutimit publik të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, personat fizikë dhe juridikë dhe organizatat e biznesit, si dhe të gjithë të interesuarit mund të marrin Raportin e me lartcekur në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit në objektin e Komunës. Po ashtu, vërejtjet dhe sugjerimet me shkrim mund të dorëzohen tek kjo drejtori.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas protokollimit në MAPL në bazë të nenit 81 të LVL.

V

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve, Zyrës për Informim, Zyrës Ligjore dhe Radio-“ALBA”.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-3701 /2015
Klinë, më 02.06

/2015



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi